



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË



Nr. 2092 prot
Himarë më 10.07.2020

MINISTRIA E DREJTËSISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. 4161/A prot.
Tiranë, më 10.07.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

BASHKISË _____

DHE

MINISTRISË SË DREJTËSISË

“Për sigurimin e kuadrit infrastrukturor dhe institucional për zbatimin e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale për të miturit në konflikt me ligjin”

Sot më datë, ____/____/____, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Bashkisë Himarë, me adresë Spile Himarë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Himarë **Z. Jorgo Goro**, këtu e në vijim **“Bashkia”**
dhe

Ministrisë së Drejtësisë me adresë: Blvd. “Zog I”, përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë **Znj. Etilda Gjonaj (Saliu)**, këtu e në vijim **“Ministria”**.

Duke qenë se Palët:

Vlerësojnë rëndësinë e përmirësimit të administrimit të drejtësisë penale për të miturit në konflikt me ligjin në kuadër të forcimit të shtetit të së drejtës dhe përmirësimit të respektimit të drejtave të njeriut;

Konsiderojnë se një ndër objektivat kyç në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel qendror dhe vendor është efikasiteti në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në përputhje me nevojat e tyre;

Marrin në konsideratë politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin dhe kërkesat për implementimin e suksesshëm të tyre;

Synojnë implementimin efektiv të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit nëpërmjet mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturve, integrimin social dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin, viktimave dhe dëshmitarëve;

Konfirmojnë angazhimin institucional për të siguruar standarde të larta të veprimtarisë dhe për të adresuar nevojat e strukturave zbatuese të ligjit për drejtësinë për të miturit për pasjen e një kuadri institucional dhe infrastrukturor mbështetës në qasje me objektivin e drejtësisë miqësore për fëmijët;

Njohin faktin se pushteti vendor është aktor kyç në garantimin e funksionimit të shërbimeve në nivel komuniteti dhe se Bashkia Himarë ka disponibilitetin maksimal për mbështetjen e grupeve në nevojë me programe të përshtatshme;

Afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje për të përmbushur angazhimet e ndërmarra në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare.

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur *Marrëveshje*.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje mes Palëve konsiston në vendosjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve për realizimin dhe mbikëqyrjen e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe dënimi (këtu e në vijim “*Masat e shmangies*”) për të miturit në konflikt me ligjin, banorë të Bashkisë Himarë.

Neni2

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në ligjin nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 9, pika. 1.6, shkonja “a”, si dhe nenin 64, shkronjat “a” dhe “gj”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Neni 3

Qëllimi

Palët bien dakord të bashkëpunojnë me qëllim zbatimin e masave të shmangies për të miturit në konflikt me ligjin nëpërmjet:

- i) ofrimin e tërësisë së shërbimeve sociale për të miturit tek Qendra 'Kopshti Himarë' në varësi të Bashkisë Himarë;
- ii) organizimin dhe pjesëmarrjen e punonjësve të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve dhe shërbimit të provës në trajnime të përbashkëta me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të strukturave të shërbimeve mbështetëse;
- iii) lehtësimin e ofrit të ndihmës dhe mbështetjes për të miturit në konflikt me ligjin dhe familjes së tij, kur kjo kërkohet prej tyre;
- iv) promovimin e modelit të drejtësisë miqësore me të miturit në konflikt me ligjin duke organizuar në ambientet e qendrës aktivitete sensibilizuese, edukative, argëtuese dhe aktivitete të tjera në përshtatje me nevojat e të miturit.

Neni 4

Roli dhe përgjegjësitë e Palëve

1. Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës merr përsipër:

- i. të koordinojë punën për ushtrimin e veprimtarisë së specialistëve të Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Vlorë të ngarkuar me ekzekutimin e masave të shmangies pranë ambienteve të Qendra 'Kopshti Himarë'.

- ii. të caktojë personin përgjegjës (mbikëqyrës) që do të ndjekë ecurinë e trajtimit të rasteve të të miturve në konflikt me ligjin, përfitues të shërbimeve sociale sipas Planit Individual të Nevojave;
- iii. të përcaktojë në bashkëpunim me personin përgjegjës që drejton Qendrën 'Kopshti Himarë' kalendarin e monitorimit të rasteve;
- iv. të njoftojë në kohë dhe pa vonesë drejtuesin e Qendrës 'Kopshti Himarë' për rastet që do të trajtohen dhe aktivitetin që do të zhvillohet;
- v. të hartojë skemat dhe programet e trajtimit të rasteve të të miturve autorë dhe/ose viktimë dhe familjarëve të tyre;
- vi. që në bashkëpunim me institucionet/agjencitë kompetente të zbatojë programet e këshillimit, drejtësisë restauruese, ndërmjetësimit dhe programet e tjera rehabilituese/riintegruuese për të miturit dhe familjen e tij, të caktuara nga prokurori në vendimin e masës së shmangies, në ambientet e Qendës 'Kopshti Himarë' ;
- vii. të organizojë në ambientet e Qendra 'Kopshti Himarë' takime periodike me përfaqësues të institucioneve ligjzbatuese për koordinimin e masave në trajtimin e çështjeve të të miturit në konflikt me ligjin;
- viii. të vendosë në dispozicion të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe drejtuesve të Qendrës 'Kopshti Himarë' listën e punonjësve të Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Vlorë që do të ndjekin ekzekutimin e masave të shmangies;
- ix. të vendosë në dispozicion, në kohë dhe pa vonesë, të punonjësit të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve dokumentacionin e nevojshëm të të miturit me qëllim koordinimin e veprimeve për menaxhimin e rastit;
- x. të organizojë trajnime të përbashkëta me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të strukturave të shërbimeve mbështetëse;
- xi. të miratojë protokollet e përbashkëta të punës për zbatimin e kësaj Marrëveshje.

2. Bashkia Himarë nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, merr përsipër:

- i. të vendosë në dispozicion të institucionit të shërbimit të provës një pjesë të ambienteve në Qendrën 'Kopshti Himarë' nën administrimin e saj, me qëllim zbatimin e programeve dhe detyrave të caktuara për zbatimin e masave të shmangies për të miturit në konflikt me ligjin;
- ii. të sigurojë punonjës nga Qendra 'Kopshti Himarë' me profil social, të specializuar për të ndjekur dhe trajtuar të miturin me masën e shmangies, viktimën dhe familjen e tij;
- iii. të përcaktojë në bashkëpunim me përfaqësuesin e shërbimit të provës kalendarin e monitorimit të rasteve;
- iv. të sigurojë bashkëpunimin e punonjësit kompetent për mbrojtjen e fëmijëve të Bashkisë, me qëllim koordinimin e përpjekjeve për të trajtuar të miturin me masën e shmangies;
- v. të shqyrtojë me përparësi kërkesat për shërbime sociale, të cilat rezultojnë të munguara duke i përfshirë në planifikimin e nevojave për shërbime dhe ngritjen e shërbimeve të reja për të miturit në konflikt me ligjin, bazuar në analizën e të dhënave të përftuara në vijimësi të kësaj Marrëveshje;

- vi. të sigurojë pjesëmarrjen e punonjësve të shërbimeve mbrojtëse në trajnimet e përbashkëta me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre;
- vii. të ofrojë shërbimet sociale të përkujdesit për të miturin në konflikt me ligjin dhe familjes së tij nga stafi i Qendrës 'Kopshti Himarë' kur kjo kërkohet prej tyre;
- viii. të kontribuojë dhe të bashkëpunojë në zbatimin e programeve dhe aktivitete të ndryshme organizuar për këshillimin, korrigjimin, ndërmjetësimin dhe programe të tjera që lidhen me zbatimin e masave të shmangies;
- ix. të miratojë protokollet e përbashkëta të punës për zbatimin e kësaj Marrëveshje.

Neni 5

Veprimtaritë e përbashkëta

Palët nëpërmjet strukturave të tyre kompetente të përcaktuara në Nenin 4 të kësaj Marrëveshje, marrin përsipër të kryejnë bashkarisht:

- i. bashkërendimin në dhënien e informacionit mbi hartimin e raportit të vlerësimit individual, programin dhe skemat e veprimtarisë që ndiqet për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masës së shmangies;
- ii. caktimin e modeleve dhe standardeve të përgatitjes së raportit të vlerësimit individual dhe metodologjisë së punës;
- iii. hartimin dhe zbatimin e skemave të veprimtarisë së përbashkët;
- iv. planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta në ambientet e Qendrës 'Kopshti Himarë';
- v. hartimin e formularëve dhe raporteve të vlerësimit të aktiviteteve dhe shërbimeve të organizuara në Qendrën 'Kopshti Himarë';
- vi. sigurimin e mjeteve teknike të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave të shmangies;
- vii. nxitjen dhe marrjen e masave mbi sensibilizimin e publikut dhe edukimin e tij, mbi llojin dhe procedurat e shërbimeve të ofruara për zbatimin e masës së shmangies pranë ambienteve të Qendrës 'Kopshti Himarë';
- viii. programimin e takimeve periodike për shkëmbimin e informacionit mbi aktivitetet e realizuara dhe bashkërendimin e atyre aktiviteteve që vlerësohen të nevojshme për t'u ndërmarrë në të ardhmen, të cilat do të jenë rrjedhojë e situatave të ndeshura në praktikë;
- ix. kryerjes së analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore;
- x. promovimin e modelit të drejtësisë miqësore me të miturit në konflikt me ligjin duke organizuar në ambientet e Qendrës 'Kopshti Himarë' aktivitete sensibilizuese, argëtuese dhe edukative.

Neni 6

Shkëmbimi i informacionit

1. Palët në mënyrë periodike, çdo 3 (tre) muaj shkëmbejnë informacion mbi numrin e të miturve të trajtuar pranë Qendrës 'Kopshti Himarë', veprimtaritë e realizuara si dhe të dhënat mbi programet dhe shërbimet e ofruara dhe mënyrën e bashkërendimit të aktiviteteve.
2. Verifikimin e përbashkët të ankesave të paraqitura mbi veprimtarinë dhe shërbimet e ofruara në ambientet e Qendrës 'Kopshti Himarë'.
3. Palët marrin përsipër të analizojnë veprimtarinë e ushtruar pranë Qendrës 'Kopshti Himarë', duke përfshirë në objektin e analizës edhe të dhëna të marra nga institucione shtetërore apo organizma të tjerë, me qëllim përgatitjen e programeve efektive për rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve.

Neni 7 Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshjelidhet për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga dita e nënshkrimit dhe do të jetë efektive përgjatë këtij afati.

Neni 8 Personat e kontaktit

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:

Për Bashkinë:

Znj. Rajmonda Zisi
Drejtore
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
E-mail: rajmondazisi@yahoo.com

Për Ministrinë e Drejtësisë: Z. Florian Murati

Drejtore
Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Vlorë
E-mail: Florian.Murati@sherbimiproves.gov.al

2. Personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që do të dalë në zbatim të Marrëveshjes.

3. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 10

Dispozita të fundit

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 7 të saj;
2. Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet Palëve.
3. Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshje pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.
4. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
5. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR
BASHKINË HIMARË**

KRYETARI

Jorgo Goro

(nënshkrim)



**PËR
MINISTRINË E DREJTËSISË**

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)

(nënshkrim)

